



Pranimar / Dorezuar Prilipenar/Prilidato Received/Delivered	07-04	2022	2	viti god year
Organ / Shista Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSTHCK	1950/2022		114	



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A. Nr. 165/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.165/2022, të datës 24.02.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rruga

kundër organit të punësimit Zyra e Kryeministrit, në çështjen juridike "vlerësim i punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa A.nr.165/2022, e datës 24.02.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETETE NE FUQI vlerësimi i rezultateve në punë, për vitin 2021 i datës 27.01.2022, për nëpunësin Civil nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.
- III. Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetar i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 24.02.2022, me numër protokolli 974/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me vlerësimin vjetor për vitin 2021 të datës 27.01.2022, të vlerësuar nga Drejtori i Departamentit të Drejtës së Bashkësisë Evropiane, si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë me arsyetim se vlerësimi vjetor, është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.03.2022, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Zyra e Kryeministrit. Ndërsa me datë 24.03.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 165/2022 me numër protokollit 974/2022 të datës 24.02.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga U.S. për A.K. i datës 25.01.2022; E-mail nga U.S. për A.K. i datës 26.11.2021; E-mail nga N.N. për U.S. i datës 25.11.2021; E-mail nga U.S. për N.N. i datës 25.11.2021; E-mail nga N.N. për U.S. i datës 25.11.2021; E-mail nga N.N. për U.S. i datës 27.01.2022; E-mail nga N.N. për U.S. i datës 24.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i U.S. i datës 27.01.2022; Shkresa përcjellëse për lëshimin e opinionit ligjor të përputhshmërisë për projekt udhëzimin administrativ (shëndetësi) nr. xx/2020 kujdesi parësor shëndetësor (kpsb) i datës 16.11.2020; shkresë e datës 16.10.2020; Opinion ligjor i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së i datës 16.11.2020; Shkresa përcjellëse me numër protokollit 3804/2 i datës 25.11.2020; Opinion ligjor i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së i datës 24.11.2020; Shkresa përcjellëse me numër protokollit 300/2 i datës 15.03.2021; Opinion ligjor i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së i datës 10.03.2021; Shkresa përcjellëse me numër protokollit 1442/15 i datës 17.06.2021; Opinion ligjor i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së i datës 16.06.2021; Shkresa përcjellëse me numër protokollit 2451/2 i datës 01.11.2021; Opinion ligjor i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së i datës 01.11.2021; Shkresa përcjellëse me numër protokollit 2985/2 i datës 24.12.2021; Opinion ligjor i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së i datës 24.12.2021; Shkresa përcjellëse me numër protokollit 3052-2/2021 i datës 18.01.2022; Opinion ligjor i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së i datës 18.01.2022; Organogrami kabinetit i Kryeministrit; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 09.03.2022; E-mail nga C.Z. për F.S. i datës 23.03.2022; Përgjigje në ankesë e datës 24.03.2022; Akt Emërimi i U.S. i datës 17.06.2019; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 11.02.2019; E-mail nga N.N. për U.S. i datës 27.01.2022; E-mail nga N.N. për U.S. i datës 24.01.2022; E-mail nga N.N. për A.K. i datës 26.01.2022; E-mail nga A.K. për N.N. i datës 26.01.2022; E-mail nga U.S. për A.K. i datës 25.01.2022; E-mail nga U.S. për A.K. i datës 26.11.2021; E-mail nga N.N. për U.S. i datës 25.11.2021; E-mail nga U.S. për N.N. i datës 25.11.2021; E-mail nga N.N. për U.S. i datës 25.11.2021; E-mail nga C.Z. për F.S. i datës 05.04.2022; E-mail nga F.S. për C.Z. i datës 05.04.2022; E-mail nga F.S. për C.Z. i datës 05.04.2022; E-mail nga N.N. për F.S. i datës 22.02.2022; E-mail nga N.N. për F.S. i datës 08.02.2022; E-mail nga N.N. për U.S. i datës 27.01.2022; E-mail nga N.N. për U.S. i datës 24.01.2022; E-mail nga F.S. për C.Z. i datës 05.04.2022; E-mail nga F.S. për C.Z. i datës 06.04.2022; Vendim me numër protokollit 92-1-2019 i datës 25.01.2019;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshill lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 të datës 27.01.2022 pasi që ka shqyrtuar pretendimet ankimore, Kolegji ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi [redacted] sipas Akt emërimit të datës 17.06.2019 është i punësuar në Ministrinë e Integritimeve Evropiane, në pozitën "Zyrtar i Lartë Ligjor".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Ministria e Integritimit Evropian është fuzionuar në kuadër të Zyrës së Kryeministrit mirëpo duke u bazuar në dispozitat e nenit 54 të Ligjit për Zyrtarët Publik nuk është bërë ristrukturimi e që rrjedhimisht të gjithë nëpunësit civil i raportojnë udhëheqësve sipas Akt Emërimit dhe përshkrimit të vendit të punës së mëhershme. Po ashtu Kolegji ka konstatuar se Udhëheqësi i Divizionit për Çështje Ligjore të BE-së duke u bazuar në Vendimin me numër protokoli 92-1-2019 të datës 25.01.2019 i cili është nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritimit Evropian, ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij. Bazuar në këto rrethana kolegji ka konstatuar se pas dorëheqjes së Udhëheqësit të Divizionit për Çështje Ligjore të BE-së për ankuesin udhëheqës i drejtpërdrejt është Drejtori i Departamentit të Drejtës së Bashkësisë Evropiane për të cilin është konfirmu në e-mailin e datës 05.04.2022 nga Zëvendësuesja e Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore.

Bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin [redacted] Kolegji konstaton se ankuesi është vlerësuar më datë 27.01.2022 nga Drejtori i Departamentit të Drejtës së Bashkësisë Evropiane, me notën e përgjithshme dy pikë e nëntëdhjetë (2.90), prandaj bazuar në vlerësimin vjetor i bërë nga Drejtori i Departamentit të Drejtës së Bashkësisë Evropiane, del se vlerësimin është bërë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Drejtori i Departamentit të Drejtës së Bashkësisë Evropiane, në rastin e vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësin civil ka vepruar në pajtim me nenin 43, paragrafi 1,2.3. dhe 4 të Ligji nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet; 1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit. 3. Objektivat përcaktohen me shkrim, në fillim të vitit, në muajin janar, së bashku me planin e veprimtarive për arritjen e objektivave. 4. Objektivat përcaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me nëpunësin dhe e bëjnë me dije atë.

Duke u bazuar në provat e lëndës në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021, të datës 27.01.2022 për ankuesin [] i vlerësuar nga Drejtori i Departamentit të Drejtës së Bashkësisë Evropiane, si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë del se ankuesi është vlerësuar me notën e përgjithshme dy pikë e nëntëdhjetë (2.90), Kolegji konstaton se vlerësimi vjetor është në pajtim me nenin 11, paragrafi 1, nen paragrafi 2.3, të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet së; 1. Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 2.3. "mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës; po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se vlerësimi është bërë edhe në pajtim me nenin 10, paragrafi 1,2,3 dhe 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se; 1. Vlerësimi për arritjen e objektivave të punës përbën 60% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit, ndërsa vlerësimi i sjelljeve profesionale të nëpunësve civilë përbën 40% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit. 2. Nota mesatare e objektivave kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë objektivave të vlerësuar dhe duke pjesëtuar me numrin e objektivave të vlerësuar. 3. Nota mesatare e sjelljeve profesionale (aftësive) kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë aftësive të vlerësuara dhe duke pjesëtuar me numrin e aftësive të vlerësuar. 4. Nota e përgjithshme kalkulohet duke mbledhur 60% (shumëzuar me 60 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të objektivave dhe 40% (shumëzuar me 40 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të aftësive.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA NR. A. NR. 165/2022

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit ;
- Udhëheqësit të Personelit në Zyrën e Kryeministrit;
- Arkivat të KPMSHCK-së,

